



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 60/2020 regjistër (JR)
Datë 18.12.2020

Nr. 32 i vendimit
Datë 14.10.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 14.10.2021 ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonci Petkovic, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ibrahim Hoxha, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2 e nenit F të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), të zhvilluar në mungesë të subjektit të rivlerësimit, i cili u njoftua rregullisht nga Kolegji dhe pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqit, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht prishjen e vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe urdhërimin e Komisionit që të klasifikojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha në kategorinë e çështjeve të papërfunduara, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ibrahim Hoxha, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ishte gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite, dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 16.06.2020. Rezulton se subjekti të paktën¹ të ketë plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting* sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme që lidheshin me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Ibrahim Hoxha, me shkresën nr. {***}, datë 24.9.2020, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor² ka dërguar dokumentacion të plotë, ndër të tjera, dhe kopje të vendimit nr. 30, datë 09.05.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Ibrahim Hoxha, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
4. Komisioni, pasi është njohur me vendimin nr. 30, datë 09.05.2017, të KLD-së, i ka kërkuar KLGj-së të shprehet si organ kompetent në lidhje me statusin e magjistratit për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha.
5. Lidhur me këtë kërkesë të Komisionit, Këshilli i Lartë i Gjyqësor³ ka konfirmuar se z. Ibrahim Hoxha i ka mbaruar statusi i magjistratit.
6. Për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha, Komisioni ka marrë konfirmimin nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit se pranë këtyre gjykatave nuk figurojnë të regjistruara çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse, subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha e me objekt kundërshtimin e vendimit të ish-KLD-së nr. 30, datë 09.05.2017, që e ka shkarkuar atë nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Bazuar në këtë situatë faktike, Komisioni, me vendimin nr. 316, datë 17.11.2020, mbështetur në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në germen “b”, pika 2 e nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në germen “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, ka konkluduar:

1. *Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Ibrahim Hoxha, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.*

¹ Për sa informacion ka në dosje, nuk ka të dhëna për deklaratat e tjera të procesit.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.10.2020.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.11.2020.

III. Shkaqet e ankimit

8. Kundër vendimit të Komisionit nr. 316, datë 17.11.2020, ka ushtruar ankim Komisioneri Publik, duke kërkuar në ankim ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Komisionit për sa i përket formulimit të pjesës urdhëruese të tij, e cila duhej të dispononte ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, për shkak se ka humbur statusin e magjistratit, meqenëse është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
9. Në ndryshim nga ky kërkim, Komisioneri Publik në parashtrimet e tij në seancë gjyqësore publike, por edhe në konkluzionet përfundimtare, pa ndryshuar shkakun ligjor të ankimit, i kërkoi Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) të prishë vendimin objekt shqyrtimi dhe të urdhërojë Komisionin të klasifikojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha në kategorinë e çështjeve të papërfunduara sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka juridiksion të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha dhe për të cilin Komisioneri Publik, nëpërmjet ankimit, kërkon prishjen e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe procedura gjyqësore e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

12.1 Përgjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik, pa ndryshuar shkakun ligjor të ankimit, ndërsa kishte kërkuar në ankim ndryshimin e vendimit të Komisionit, i kërkoi Kolegjit të prishë pikën 1 të vendimit objekt shqyrtimi, i cili ka vendosur të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Ibrahim Hoxha pa një vendim përfundimtar, duke urdhëruar Komisionin të klasifikojë procesin e rivlerësimit për këtë subjekt në kategorinë e çështjeve të papërfunduara, sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Procesi gjyqësor në Kolegj u zhvillua në mungesë të subjektit të rivlerësimit i cili, megjithëse u njoftua rregullisht për seancat gjyqësore të zhvilluara, nuk u paraqiti dhe as paraqiti ndonjë arsye apo shkak të ligjshëm për mosprezencën⁴ e tij.

12.2 Komisioneri Publik Darjel Sina paraqiti në seancë gjyqësore parashtrimet lidhur me ankimin e tij, në të cilat Kolegji konstatoi se kishte ndryshuar kërkimi përfundimtar i tij në lidhje me vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, në raport me kërkimin e tij në ankim, duke kërkuar nga “ndryshimin e pikës 1 të vendimit dhe deklarimin të ndërprerë të procesit të rivlerësimit për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë” në “prishjen e vendimit të Komisionit nr. 316, datë 17.11.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Hoxha, dhe urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të klasifikojë të papërfunduar procesin e rivlerësimit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Hoxha”. Kolegji konstatoi gjithashtu se ky kërkim nuk ishte shoqëruar me ndryshim të shkakut ligjor mbi të cilin ishte mbështetur ankimi dhe për këtë shkak, duke arsyetuar edhe mbi rolin dhe veçoritë e Komisionerit Publik në procesin e rivlerësimit, i cili karakterizohet nga specifikat e tij, vlerësoi se gjendemi në thelb para të njëjtit ankim për të cilin Komisioneri kishte vënë në lëvizje gjykatën dhe se kërkimi i ndryshëm në lidhje me dispozitivin e vendimit nuk ndryshonte kundërshtitë e Komisionerit ndaj vendimit të Komisionit objekt gjykimi, por vetëm qartësonte kërkimin e tij përfundimtar.

12.3 Në kushtet kur seanca gjyqësore në të cilën trupa gjyqësore u bë me dije me këtë ndryshim, zhvillohej në mungesë të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerësoi të njoftojë subjektin me këtë ndryshim, duke zbatuar me analogji nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile⁵, për t'i dhënë atij mundësinë të mbrohet e dëgjohet edhe ndaj këtij kërkimi të modifikuar rishtas nga Komisioneri Publik, në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së

⁴ Në seancën e parë gjyqësore të zhvilluar në Kolegj më datë 04.10.2021, subjekti i rivlerësimit rezultoi në mungesë pa shkaqe të arsyeshme, edhe pse ishte njoftuar në të njëjtën adresë elektronike dhe të banesës tek e cila, sipas të dhënave të fashikullit, rezultoi në ishin kryer të gjitha njoftimet e Komisionit.

- Kolegji, për të vërtetuar se njoftimet për zhvillimin e seancave gjyqësore ishin në përputhje me parashikimet e nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur në fashikullin gjyqësor të përcjellë në Kolegj mungonte deklarata sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, e njohur si deklarata vetting, me vendim të ndërmjetëm kërkoi nga Komisioni administrimin e deklaratës vetting, e cila do të shërbente për të identifikuar adresën elektronike të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, të vlefshme për komunikimet lidhur me procesin e rivlerësimit.
- Në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues të Kolegjit, Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 27.07.2021, i vuri në dispozicion Kolegjit deklaratën vetting të plotësuar sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 nga subjekti i rivlerësimit, tek e cila rezultoi se adresa elektronike dhe ajo e banimit ishin të njëjta me ato të cilat Kolegji kishte njoftuar subjektin e rivlerësimit për zhvillimin e seancës gjyqësore në Kolegj.
- Përpos kësaj të dhëne, me qëllim garantimin e plotë të elementeve të procesit të rregullt ligjit si e drejta për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, Kolegji pasi administroi nga Komisioni deklaratën vetting, njoftoi subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha si në adresën elektronike, ashtu edhe me shkresë në adresën e banimit të deklaruar në deklaratën vetting, për datën e seancës gjyqësore të radhës lidhur me procesin e tij të rivlerësimit, ishte caktuar më datë 13.09.2021.
- Seanca e radhës e datës 13.09.2021, nuk u zhvillua për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe u shty për t'u zhvilluar në datë 04.10.2021, e cila gjithashtu iu njoftua prej Kolegjit sërish subjektit të rivlerësimit.

⁵ Paditësi, gjatë veprimeve përgatitore, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për ndryshimin e shkakut të padisë. Ai pa ndryshuar shkakun e padisë, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e saj. 2. Në seancë gjyqësore mund të shtohet, pakësohet ose ndryshohet vetëm objekti i padisë, kur një nevojë e tillë lind për shkak të provave të marra në seancën gjyqësore. 3. Kur ndryshimet e mësipërme bëhen në mungesë të të paditurit ose të personave të tretë të thirrur në gjykim, duhet t'u komunikohen atyre me shkrim.

Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNj-së. Subjekti i rivlerësimit edhe pas këtij komunikimi⁶, sërish nuk u paraqiti në gjykim dhe as paraqiti ndonjë pretendim rreth tij.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

13. Në ankimin ndaj vendimit të Komisionit nr. 316, datë 17.11.2020, Komisioneri Publik ka pretenduar se arsyetimi dhe vendimmarrja e Komisionit nuk gjejnë mbështetje në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore në drejtim:

- i. të efektit të mbarimit të statusit të magjistratit në procesin e rivlerësimit;
- ii. të rasteve kur vendoset ndërprerja e procesit të rivlerësimit apo përfundimi i procesit të rivlerësimit pa vendim përfundimtar.

13.1 Komisioneri Publik, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka argumentuar se shkaqe për mbarimin e ushtrimit të detyrës si gjyqtar apo prokuror, referuar Kushtetutës, janë ato të parashikuara në nenin 140, pika 2, nenin 148/d, pika 2 e Kushtetutës, dhe krahas tyre edhe “moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit”, sipas nenit 179/b, pika 7 e saj. Ndërkohë, neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon ndërprerje të procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes nga detyra.

13.2 Sipas Komisionerit Publik, referuar sanksionimeve kushtetuese, shkaqet janë të pavarura nga njëri-tjetri, ndaj dhe secili prej shkaqeve qëndron më vete si masë disiplinore, si rrjedhojë shkaku i shkarkimit, pasi magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për një krim, nuk mund të shërbejë si shkak *per se (më vete)* për moskalimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

Këto qëndrime, Komisioneri Publik i mbështet në përcaktimet e neneve 140/2 dhe 148/2 të Kushtetutës, të cilat parashikojnë rastet kur gjyqtari dhe prokurori shkarkohen nga organet kompetente, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë, pra janë dispozita që rregullojnë veprimtarinë e këtyre organeve.

13.3 Në parashtrimet e tij dhe në konkluzionet përfundimtare të çështjes, Komisioneri Publik pretendoi se në deduksion të analizës së tij, se fakti që procesi penal ndaj subjektit të rivlerësimit ishte ende i varur në Gjykatën e Lartë, në pritje për t’u gjykuar mbi rekursin e paraqitur prej vetë subjektit, e bënte hipotetikusht të cenueshëm vendimin e Komisionit që kishte përfunduar procesin e tij të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar. Ky vendim duhej të prishej sipas këndvështrimit të Komisionerit Publik dhe procesi i rivlerësimit për subjektin Ibrahim Hoxha të konsiderohej si një proces që do të përfundohej nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, në eventualitetin që subjekti rifitonte statusin e magjistratit pas shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

13.4 Nga analizimi i fakteve që rezultojnë nga provat dokumentare të administruara në Komision, Kolegji vlerëson të analizojë në mënyrë të përmblendhur disa fakte që konsiderohen të rëndësishme për çështjen.

- i. Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, Ibrahim Hoxha ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për këtë arsye sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit

⁶ Të cilat iu përcollën për njohje subjektit të rivlerësimit dhe u njoftua se seanca tjetër gjyqësore vijuese do të ishte më datë 13.10.2021.

nr. 84/2016, ai gëzonte pozitën e subjektit të rivlerësimit *ex officio* dhe rezulton që të paktën⁷ të ketë plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting* sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

- ii. Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), me vendimin nr. 55, datë 03.05.2016, ka vendosur pezullimin e gjyqtarit Ibrahim Hoxha nga ushtrimi i detyrës – *pasi, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***} prot., datë 03.05.2016, për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit personal, ndërsa ka qenë në ushtrimin e funksionit, subjekti i rivlerësimit është arrestuar në flagrancë dhe ndaj tij ka filluar një çështje penale – deri në marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor në këtë çështje penale.*
- iii. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale në ngarkim të tij, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin **nr. {***}, datë 21.12.2016**, ndër të tjera ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit Ibrahim Hoxha për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe, në bazë të nenit 319/ç të Kodit Penal, ka vendosur dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim. Në aplikim të neni 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e të pandehurit Ibrahim Hoxha me 2 (dy) vjet burgim. Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet për të pandehurin Ibrahim Hoxha duke qenë se ka kryer një krim që lidhet me detyrën duke shpërdoruar funksionin publik.*
- iv. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka marrë formë të prerë, pasi Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin **nr. {***}, datë 12.04.2017**, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 21.12.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në tërësinë e tij, me ndryshimin: në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimin me burgim për pjesën e mbetur për të pandehurin Ibrahim Hoxha dhe vënin në provë për një kohë prej 18 muajsh.*
- v. Ndaj vendimit nr. {***}, datë 12.04.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar rekurs, i cili është në pritje për t’u gjykuar nga Gjykata e Lartë⁸.
- vi. Pas administrimit të vendimit nr. {***}, datë 12.04.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, KLD-ja, me vendimin **nr. 30, datë 09.05.2017**, ka vendosur: *Të shkarkojë nga detyra e gjyqtarit pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Ibrahim Hoxha, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.*
- vii. Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.11.2020, përcjellë Komisionit, është shprehur ndër të tjera se: *[..] ndaj gjyqtarit Ibrahim Hoxha është marrë masa disiplinore e shkarkimit nga funksioni, nga organi kompetent, sipas ligjit të kohës, ish-KLD-ja, vendim kundër të cilit gjyqtari i shkarkuar nuk ka paraqitur ankim brenda afatit të përcaktuar në ligj. Për këtë arsye, vendimi nr. 30, datë 09.05.2017, i ish-KLD-së, konsiderohet se ka marrë formë të prerë, duke passjellë dhe efektet juridike përkatëse. Nisur nga kjo, në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të shkronjës “ç” të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor konfirmon se z. Ibrahim Hoxha i ka mbaruar statusi i magjistratit.*
- viii. Nga të dhënat e fashikullit, rezulton se Komisioni ka verifikuar përkatësisht pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Gjykatës Kushtetuese, si dhe Gjykatës së Lartë nëse z. Ibrahim Hoxha ka

⁷ Për sa informacion ka në dosje, nuk ka të dhëna për deklaratat e tjera të procesit.

⁸ Shih: http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2017-04673&ln=Lng1&uni=20211206141540134059357906513892

ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 30, datë 09.05.2017, të ish-KLD-së që e ka shkarkuar atë nga detyra dhe këto gjykata⁹ kanë shprehur se pranë tyre nuk është i depozituar asnjë ankim me palë ankuese subjektin dhe me objekt kundërshtimin e vendimit të KLD-së që e ka shkarkuar atë nga detyra.

13.5 Duke pasur në konsideratë situatën faktike të përshkruar më lart, kuadrin ligjor të zbatueshëm dhe pretendimet e kërkimin përfundimtar të Komisionerit Publik, Kolegji çmoi se para tij shtrohen për zgjidhje çështjet e mëposhtme.

- i.** Nëse në kohën e marrjes prej Komisionit të vendimit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e magjistratit.
- ii.** Në eventualitetin e humbjes së statusit të magjistratit, cila do të jetë konsequenca ligjore në procesin e tij të rivlerësimit.
- iii.** Në konsiderim të konkluzioneve të çështjeve më sipër, cili do të jetë legjislacioni i zbatueshëm që përcakton edhe vendimmarrjen e Komisionit në pjesën urdhëruese të tij.

13.6 Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për zgjidhje, Kolegji konstaton se z. Ibrahim Hoxha në kohën e hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjit nr. 84/2016, ishte i emëruar me detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pavarësisht faktit se ai u vendos në kushtet e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, për shkak të procedimit penal që u regjistrua në ngarkim të tij për kryerjen e veprës penale *Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe u pezullua nga detyra për këtë arsye me vendim të KLD-së, ai përsëri gëzonte statusin e gjyqtarit/magjistratit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016 dhe, në këto kushte, ai ka plotësuar e dorëzuar në ILKDPKI deklaratën e pasurisë *vetting* në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016. Në këtë mënyrë, procesi i rivlerësimit ndaj këtij subjekti ka nisur *ex officio*, me hyrjen në fuqi të ligjit, ndërsa procedura administrative për kryerjen e këtij procesi ka startuar ndaj tij me hedhjen e shortit në datën 16.06.2020.

13.7 Në kohën që nisi procedura administrative për kryerjen e procesit të rivlerësimit ndaj këtij subjekti, u konstatua se ai ishte shkarkuar nga KLD-ja për shkak të marrjes formë të prerë të vendimit penal që e kishte deklaruar atë fajtor e dënuar për veprën penale të cituar më lart. Rezulton nga verifikimet e kryera nga Komisioni e të konstatuara edhe nga Kolegji, se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të KLD-së që ka vendosur shkarkimin e tij, në asnjë prej gjykatave të cilave ai mund t’i drejtohej për shkak të periudhës tranzitore në të cilën ndodheshin institucionet e reja të drejtësisë. Subjekti nuk paraqiti asnjë kundërshti apo ankim/pretendim ndaj këtij vendimi as në gjykimin në Kolegji, megjithëse ai u njoftua disa herë radhazi për seancat gjyqësore të zhvilluara për gjykimin e kësaj çështjeje, dhe nuk demonstroi asnjë vullnet për të provokuar një deklaramosdakordësie për vendimmarrjen e shkarkimit as para Kolegjit, si gjykata e vetme sot që ka juridiksion për shqyrtimin e vendimeve të këshillave gjyqësorë e të prokurorisë në rastet e vendosjes së masave disiplinore ndaj magjistratëve.

13.8 Nga kjo analizë, rezulton se në datën 17.11.2020, në të cilën është marrë vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit kishte humbur statusin e magjistratit në bazë të vendimit nr. 30, datë 09.05.2017, të KLD-së, i cili ka shkarkuar subjektin nga detyra e gjyqtarit për shkak të dënimit të tij për kryerjen e një krimi me vendim penal të formës së prerë. Ky vendim i organit kompetent i cili ka shkaktuar edhe mbarimin e statusit për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit

⁹ Këto gjykata kanë kthyer përgjigje me shkresat:

- Kolegji i Posaçëm Apelit, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.11.2020;
- Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.11.2020;
- Gjykata e Lartë, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.09.2020.

64, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 96/2016, ka marrë formë të prerë dhe nuk rezulton të jetë kundërshtuar prej tij në rrugë gjyqësore apo administrative sipas legjislacionit në fuqi.

13.9 Në këto kushte, Kolegji konstaton se situata faktike e cila i është nënshtruar vlerësimit të Komisionit, nuk ka pasur asnjë ekuivok në drejtim të sigurisë së faktit se subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e magjistratit dhe asnjë çështje nuk gjendej e varur në ndonjë gjykatë kompetente për të zgjidhur ndonjë pretendim rreth kësaj situatë.

13.10 Kolegji vlerëson se nëse në të ardhmen kjo situatë faktike do të ndryshojë për shkak të një disponimi në mbështetje të rekursit të depozituar prej subjektit në Gjykatën e Lartë, lidhur me vendimin penal të dënimit të tij, rikthimi i tij në detyrë dhe rifitimi i statusit të magjistratit do ishin ngjarje krejt hipotetike, të cilat do të vareshin mbi një sërë faktorësh që lidhen si me vullnetin e subjektit, por edhe me zbatimin e legjislacionit relevant që do të zgjidhte çështjen. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se pretendimi i Komisionerit Publik se duhet gjykuar vendimi i Komisionit mbi ngjarje që mund të ndodhin në të ardhmen, është i padrejtë dhe i pambështetur në dispozitat procedurale administrative që përcaktojnë kufijtë dhe fushën e kontrollit të vendimeve të organeve administrative prej gjykatës. Neni 37, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon se: *Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ*, për pasojë çdo pretendim që mund të ngrihet në të ardhmen rreth sigurisë së ekzistencës së kësaj gjendjeje juridike, për shkak të ngjarjeve që mund të ndodhin, sipas vlerësimit të Kolegjit, në kontekstin e situatës faktike të përshkruar më lart, nuk i përket vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit, në kuptim të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi.

13.11 Për sa u arsyetua më lart, Kolegji, në përgjigje të çështjes së parë të shtruar për zgjidhje, arriti në konkluzionin se në kohën e marrjes së vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e magjistratit, dhe kjo ishte e vetmja rrethanë që duhej të vlerësohej nga Komisioni në marrjen e vendimit për procesin e tij të rivlerësimit.

13.12 Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje, Kolegji, duke përdorur si bazë konkluzionin e arritur më sipër, lidhur me humbjen e statusit të magjistratit prej subjektit, shqyrtoi legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret dhe, sipas kësaj analize, konkludoi se procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdojë për një subjekt rivlerësimi që nuk e gëzon më këtë status në momentin e dhënies së vendimit. I gjithë procesi i rivlerësimit i konceptuar dhe miratuar si një proces që do t'i shërbejë qëllimit kushtetues të pastrimit të radhëve të magjistratëve nga individë që nuk e gëzojnë besimin e publikut, u adresohet të gjithë atyre që janë pjesë e sistemit të drejtësisë, ky proces nuk është parashikuar të jetë *per se*, një qëllim edhe për ata që nuk janë më pjesë e këtij sistemi. Qëllimi kushtetues në këto raste, është realizuar nëpërmjet mekanizmave të tjerë ligjorë, siç është në këtë rast, shkarkimi i subjektit nga detyra e gjyqtarit për shkak të dënimit me një vendim penal për kryerjen e një krimi.

13.13 Në vijim të këtij arsytimi dhe në konsideratë të situatës faktike, Kolegji shqyrtoi dhe analizoi vendimin e Komisionit në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, dhe nga kjo analizë nuk konstatoi shkeljen e asnjë prej tyre. Subjekti i rivlerësimit Ibrahim Hoxha e ka fituar statusin e magjistratit në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, dispozita të cilat e lidhin pasjen e këtij statusi me pasjen e statusit të magjistratit, si edhe përcaktojnë zhvillimin e procesit të rivlerësimit *ex officio* për këtë kategori. Humbja e statusit të magjistratit me vendim të formës së prerë të organit kompetent, kushtëzon edhe humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit sipas dispozitave të cituara, e për pasojë rrëzon vetë objektin e procesit të rivlerësimit i cili synon rivlerësimin e subjekteve sipas kategorizimit të më lart cituar.

13.14 Në përfundim të analizës mbi këtë çështje, Kolegji arrin në konkluzionin se humbja e statusit të magjistratis është një rrethanë që kushtëzon procesin e tij të rivlerësimit, i cili mbetet në këtë rast pa një objekt sipas përcaktimit të legjislacionit të cituar më lart.

13.15 Në lidhje me çështjen e tretë të shtruar për zgjidhje, Kolegji analizoi dispozitat ligjore në fuqi, të cilat do të përcaktonin për Komisionin legjislacionin e zbatueshëm sipas të cilit do të duhej të normohej mënyra e zgjidhjes së çështjes në pjesën e saj urdhëruese.

13.16 Në konsiderim të konkluzioneve të arritura për çështjet më sipër, Kolegji vlerëson se në kushtet kur procesi i rivlerësimit për ish-magjistratin Ibrahim Hoxha ka mbetur pa objekt dhe e ka humbur qëllimin e tij, për sa kohë që qëllimi kushtetues i kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nëpërmjet pastrimit të radhëve të magjistratëve nga ata që nuk e gëzojnë këtë besim, është arritur gjithsesi nëpërmjet shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet një juridiksioni tjetër kushtetues, Komisioni në momentin që ka nisur procedurat administrative për kryerjen e këtij procesi, me të drejtë ka marrë në konsideratë këtë situatë faktike dhe dispozitat ligjore të cituara më lart.

13.17 Nga leximi i dispozitave kushtetuese dhe atyre të ligjit të posaçëm nr. 84/2016, nuk konstatohet një rregullim i ligjor dedikuar këtij rasti apo situatës së ndërtuar sipas rrethanave të faktit objekt gjykimi. Në këto rrethana, Kolegji e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të thirrur për zbatim dispozitat referuese që vetë ligji i posaçëm ka përcaktuar se duhen zbatuar në mungesë të zgjidhjeve të dedikuara posaçërisht rasteve konkrete. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vëren se në mungesë të një rregullimi të posaçëm në ligjin nr. 84/2016 për zgjidhjen e një situatë të tillë dhe në zbatim të dispozitave referuese që përcakton neni 4, pika 6 e këtij ligji, me të drejtë Komisioni ka aplikuar nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative për zgjidhjen ligjore të situatës faktike të krijuar.

13.18 Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton disponimin e organeve publike në rastet kur procedimet administrative mbeten pa objekt. Duke e konsideruar rastin si të tillë, Kolegji vlerëson se pikërisht përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar siç përcakton kjo dispozitë, është mënyra e drejtë e disponimit e cila konstatohet se edhe është përdorur prej Komisionit.

- 14.** Në analizë të sa më sipër, Kolegji konkludon se pretendimi i Komisionerit Publik se vendimi i Komisionit duhet të priset dhe procesi i rivlerësimit për subjektin duhet të konsiderohet si i papërfunduar, duke urdhëruar Komisionin ta përfshijë atë në kategorinë e çështjeve për të cilat, sipas pikës 8 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi do të vijojë të kryhet pas përfundimit të periudhës së rivlerësimit kalimtar, në këtë rast nga KLGj-ja, gjendet i padrejtë dhe i pambështetur në ligj.
- 15.** Vendimi i Komisionit objekt gjykimi jo vetëm u gjet i drejtë nga Kolegji, qoftë në pikëpamje të arsyetimit dhe bazës ligjore të përdorur, qoftë edhe në përcaktimin e dispozitivit të tij, por gjithashtu Kolegji e gjen të pambështetur pretendimin e Komisionerit Publik se kjo çështje do të duhej të trajtohej sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, dispozitë e cila rregullon pasojat e kontinuitetit të procesit të rivlerësimit dhe përcakton organet kompetente të cilat do të marrin përsipër kompetencat e organeve të rivlerësimit pas mbarimit të mandatit të tyre kushtetues, por nuk vendos rregulla për përcaktimin e kategorive të çështjeve që do të trajtohen në atë fazë të procesit. Përcaktimi i këtyre rregullave me anë të vendimmarrjeve të Komisionit apo orientimit të vendimeve të Kolegjit, vlerësohet se do të ishte në shkelje të parimit të diskrecionit, për sa kohë që vetë ligji nuk ka autorizuar përcaktimin e tyre nga organet e rivlerësimit.
- 16.** Në përfundim të sa më sipër, Kolegji nuk e gjen të drejtë e të mbështetur në interesin publik ankimin e paraqitur prej Komisionerit Publik, qoftë për sa i përket shkakut ligjor, ashtu edhe kërkimin e tij. Për pasojë, duke arsyetuar si më lart, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi është marrë në vlerësim të drejtë të situatës faktike e zbatimit korrekt të kuadrit ligjor dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ibrahim Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 14.10.2021

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi